

APEL PËR KURSIMITIN E UJIT

Të dashur qytetarë dhe konsumatorë të kompanisë së ujësjellësit "Hidromorava" Gjilan, siç e dini edhe ju kompania është duke u përballur me mungesë të ujit në burimet e saja, veçanërisht problem paraqitet te burimi kryesor Penda në Përlepnicë ku niveli i ujit në Pendë është 16,70 m nga niveli 30,30 m, pra 13,60 m më poshtë nga kuota maksimale, dhe duke marrë parasysh ku mbi 7 m e fundit të pendës nuk janë të shfrytëzueshme mbetet sasi relativisht e vogël në shfrytëzim.

Kompania apelon qytetarët që të kursejnë ujin dhe mos ta keqpërdorin, mos ta shfrytëzojnë për:

- Larjen e automjeteve;
- Ujitjen e kopshteve dhe trotuareve;
- Mos i leni rubinetet hapur pa nevojë;
- Mos të përdoret për punë ndërtimore, sidomos banesat kolektive që janë duke u ndërtuar;
- Lajmëroni rrjedhjet në kompani;
- dhe çdo formë tjetër të keqpërdorimit.

Kryeshefi Ekzekutiv ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me Inspektoratin Komunal dhe Kryetarin e Komunës së Gjilanit për parandalimin e keqpërdorimit të ujit, andaj punëtorët e kompanisë së bashku me Inspektoratin Komunal nga Drejtoria e Shërbimeve të Komunës do të jenë në teren gjatë gjithë kohës dhe kushdo që haset duke keqpërdorë ujin si në pikat e lartcekura do të shkyçet nga rrjeti i ujësjellësit dhe lënda do të procedohet në Gjykatën Themelore Gjilan,

Kompania përmes autocisternave do të jetë në teren gjithë kohën dhe të gjithë ju që keni nevojë kontaktoni numrat e tanë të telefonave.

info@kru-hidromorava.com

Tel:0280326980

Mob:044983071

Kujdestaria inaktive: 044719813

Me respekt

Muhamed Suliqi

Kryeshef Ekzekutiv

KRU "Hidromorava" sh.a

Qershor, 2019